

Mekanizmi i Pavarur i Raportimit

Rishikimi i Planit të Veprimit:
Kosova 2023–2025

Open
Government
Partnership



Independent
Reporting
Mechanism

Tabela e përmbajtjes

Pjesa I: Pamje e përgjithshme e Planit të Veprimit 2023-2025	2
Pjesa II: Zotimet premtuese në Planin e Veprimit të Kosovës 2023-2025	4
Pjesa III. Metodologjia dhe Treguesit e MPR-së	14
Shtojca 1. Të dhënat e secilit zotim	17
Shtojca 2: Bashkë-krijimi i Planit të Veprimit	19

Shënim editorial: Në mars të vitit 2023, Komiteti Drejtues i Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (PQH) miratoi vendimin për të lejuar shtetet jo të njohura botërisht, siç përcaktohet nga anëtarësimi në Kombet e Bashkuara (OKB), të bëhen anëtarë të PQH-së. Anëtarësia në OKB dhe agjencitë e saja të specializuara rregullohet nga Karta e Kombeve të Bashkuara dhe nga agjencitë e specializuara përkatëse. PQH-ja dhe Mekanizmi i Pavarur i Raportimit (MPR) nuk zotërojnë autoritetin për të njohur as shtete dhe as qeveri. Anëtarët e MPR-së që nuk njihen botërisht nuk kanë të drejtë të kandidojnë për Komitetin Drejtues të MPR-së ose të votojnë në përzgjedhjen e anëtarëve të tij. Pjesëmarrja në PQH nuk përbën mbështetje ose njohje të statusit ndërkombëtar të një shteti dhe as nuk do të ndikojë në pozicionin individual të asnjë pjesëmarrësi të PQH-së në këtë drejtim.

Pjesa I: Pamje e përgjithshme e Planit të Veprimit 2023-2025

Plani i parë i veprimit të Kosovës trajton fushat kryesore të qeverisjes së hapur, duke përfshirë të dhënat e hapura, pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, prokurimin publik dhe transparencën e financave politike. Plani i veprimit ka parë një proces ambicioz të bashkë-krijimit me përfshirjen aktive të Këshillit Koordinues Kombëtar, forumit shumëpalësh të Kosovës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duhet ta vazhdojë këtë punë duke angazhuar shoqërinë civile në zbatimin e zotimeve.

Plani i veprimit të Kosovës 2023-2025, i pari si anëtare pa të drejtë vote në PQH, vjen 10 vjet pasi Qeveria e Kosovës shprehu për herë të parë interesin për t'iu bashkuar PQH-së në vitin 2013.¹ Plani i veprimit përmban 13 zotime që mbulojnë shërbimet publike digjitale, të dhënat e hapura, pjesëmarrjen e publikut dhe anti-korrupsionin.² Zotimet përputhen me prioritetet e qeverisë rreth qeverisjes së mirë, antikorrupsionit, transparencës dhe digjitalizimit të sektorit publik.

Në mars të vitit 2023, Komiteti Drejtues i PQH-së miratoi një vendim që lejonte shtetë jo të njohura botërisht (siç përcaktohet nga anëtarësimi në Kombet e Bashkuara) të bëhen anëtarë pa të drejtë vote në PQH.³ Ndërsa priste këtë mundësi, Kosova punoi për të përmbushur kriteret e përshtatshmërisë teknike të PQH-së, kaloi Kontrollin e Vlerave dhe përgatiti një plan veprimi të PQH-së. Pasi Komiteti Drejtues mori vendimin e vet, Kosova dërgoi letrën e interesit për t'iu bashkuar PQH-së më 17 korrik 2023.⁴ Më 31 korrik 2023, Komiteti Drejtues përshëndeti anëtarësimin e Kosovës në PQH dhe e ftoi Kosovën të marrë pjesë në Samitin Global të PQH-së në Talin, Estoni, më 6-7 shtator 2023.⁵

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) krijoi Komitetin Koordinues Kombëtar (KKK) në tetor të vitit 2021 si forum me shumë palë të interesuara në Kosovë. Procesi i bashkë-krijimit filloi me një periudhë konsultimi dymujore nga 8 mars deri më 29 prill 2022 dhe përfshiu 11 takime të KKK-së, duke përfshirë katër punëtori tematike dhe shtatë diskutime publike në komunat kryesore të Kosovës. Një përfaqësues i shoqërisë civile vuri në dukje se historia e pikës së kontaktit të MAPL-së në shoqërinë civile ndihmoi në lehtësimin e një procesi shumë të hapur dhe pjesëmarrës të bashkë-krijimit.⁶ Në shtator-tetor 2022, MAPL-ja publikoi planin paraprak të veprimit për konsultim publik dhe buxheti ishte përgatitur në nëntor 2022 për miratim nga qeveria në dhjetor 2022.⁷ Kur u konfirmua se Kosova kishte të drejtë t'i bashkohej PQH-së, MAPL-ja organizoi një numër tjetër konsultimesh për planin e veprimit nga maji deri në korrik 2023. Plani i veprimit u miratua në dhjetor 2023.⁸

Një shikim i shpejtë

Merr pjesë që nga: 2023 (si anëtare pa të drejtë vote)

Numri i zotimeve: 13

Përmbledhja e zotimeve:

Zotimet me një lente të Qeverisë së hapur: 13 (100%)

Zotimet me mundësi të konsiderueshme për rezultate: 0

Zotimet premtuese: 2

Fushat e politikave:

- Qeverisja digjitale
- Të dhënat e hapura
- Pjesëmarrja qytetare
- Hapësira qytetare
- Prokurimi publik
- Financat politike

Pajtueshmëri me kërkesat minimale të PQH-së për bashkë-krijim: Jo

Proceset e ardhshme të bashkë-krijimit mund të përfitojnë nga dokumentacioni më i madh në faqen e internetit të PQH-së të Kosovës. Për shembull, MAPL-ja mund të publikojë afatin kohor të bashkë-krijimit dhe pasqyrën e mundësive që palët e interesuara të marrin pjesë të paktën dy javë para fillimit të procesit të zhvillimit të planit të veprimit. MAPL-ja gjithashtu mund të publikojë komente të detajuara për përzgjedhjen e zotimeve, duke përfshirë arsyetimet se pse propozimet e zotimeve janë miratuar apo nuk janë miratuar.

Zotimet janë ambicioze dhe relevante për qëllimin e Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE). MPR-ja identifikoi dy zotime si premtuese, të cilat mund të përmirësojnë shumë praktikatat e hapura të qeverisë në Kosovë. Zotimi 4.1 synon hapjen e të dhënave në të gjitha fazat e prokurimit publik duke miratuar ndryshime në Ligjin për Prokurimin Publik. Ky zotim mund të përmirësojë prokurimin elektronik në Kosovë dhe t'i harmonizojë politikat e prokurimit të Kosovës me Direktivën e Prokurimit të BE-së të vitit 2014. Zotimi 4.3 përfshin zhvillimin e një platforme për të dhëna të hapura mbi financat (të ardhurat dhe shpenzimet) e partive politike të regjistruara. Shumë prej zotimeve, megjithëse të verifikueshme, do të përfitonin nga përshkrimet më të qarta të ndryshimeve të pritshme në praktikatat ekzistuese nga zbatimi i tyre.

Meqenëse ky është plani i parë i veprimit të Kosovës, do të jetë e rëndësishme të ruhet momenti politik duke informuar rregullisht KKK-në për zbatimin e zotimeve. Për më tepër, MAPL-ja duhet të sigurojë që Kosova të përmbushë standardet e PQH-së për Pjesëmarrjen dhe Bashkë-Krijimin gjatë zbatimit të planit të veprimit. Kjo përfshin:

- përditësimin e faqes së internetit të PQH-së të Kosovës të paktën dy herë në vit me dëshmi për zbatimin e zotimeve,
- mbajtjen e të paktën dy takimeve çdo vit me shoqërinë civile (d.m.th. nëpërmjet KKK-së) për të paraqitur rezultatet mbi zbatimin e planit të veprimit dhe për të mbledhur komente.

¹ Republika e Kosovës, Plani Kombëtar i Veprimit për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur 2023-25,

https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2023/12/Kosovo_Action-Plan_2023-2027_December_EN.pdf

² Kosova miratoi planin e veprimit të PQH-së për 2014-2016, para se të bëhej anëtare pa të drejtë vote në PQH, por zbatimi i këtij plani ishte i kufizuar. Fidan Kajala (Pika e Kontaktit, Qeveria e Kosovës) dhe Blerta Thaçi (Drejtoreshë Ekzekutive, Open Data Kosovo), intervista nga MPR-ja, 23 maj 2024.

³ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Propozim për të ndryshuar politikën se kush mund të bëhet anëtar i PQH, 2 mars 2023, https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2023/03/SC_Proposal-on-OGP-membership-requirements-For-SC-approval_20230307-.pdf

⁴ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Kosovë – Letra e synimit për t'iu bashkuar PQH-së, 29 gusht 2023, <https://www.opengovpartnership.org/documents/kosovo-letter-of-intent-to-join-ogp/>

⁵ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, 31 korrik 2023, https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2023/08/Kosovo_Co-Chairs-Welcome-Letter_20230731.pdf

⁶ Bashkëkryetarja e shoqërisë civile e KKK-së, intervistë e kryer nga MPR-ja.

⁷ Faqja e internetit Open Data Kosovo, <https://opendatakosovo.medium.com/kosovo-towards-a-new-national-action-plan-for-ogp-d44e2f3fb6a3>

⁸ Fidan Kajala (PeK), korrespondencë me MPR-në, qershor 2024.

Pjesa II: Zotimet premtuese në Planin e Veprimit të Kosovës 2023-2025

Rishikimi i mëposhtëm hulumton dy zotimet dhe një grup fushash që MPR-ja identifikoi se kanë potencialin për të realizuar rezultatet më premtuese. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të ambicies, zotimet premtuese trajtojnë një fushë politikash që është e rëndësishme për palët e interesuara ose kontekstin kombëtar, janë të verifikueshme, kanë një lente të hapur qeveritare dhe kanë potencial të konsiderueshëm për rezultate. Ky rishikim ofron edhe një analizë të sfidave, mundësive dhe rekomandimeve për të kontribuar në procesin e të mësuarit dhe zbatimit të këtij plani veprimi.

Tabela 1. Zotimet premtuese

Zotimet premtuese
4.1 Sistemi i prokurimit publik plotësisht i hapur: Ky zotim synon hapjen e të dhënave të prokurimit publik që kanë lidhje me të dhënat duke miratuar ndryshime në Ligjin për Prokurimin Publik.
4.2 Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe kontrollit financiar të partive politike të regjistruara në Republikën e Kosovës: Ky zotim synon krijimin e një platforme online me të dhëna të hapura për financat e partive politike të regjistruara.

Zotimi numër 4.1: Sistemi i prokurimit publik plotësisht i hapur (Ministria e Financave, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik)

Për një përshkrim të plotë të këtij zotimit, shih Zotimin 4.1 në planin e veprimit [këtu](#).

Konteksti dhe objektivat

Kosova ka një politikë fiskale të menaxhuar mirë, por ka nevojë të zgjerojë shërbimet publike dhe të mbyllë boshllëqet e infrastrukturës.⁹ Sektori i ndërtimit është në rritje dhe është e nevojshme të reduktohen rreziqet e korrupsionit në investimet publike.¹⁰ Sektori i ndërtimit është më i prirur ndaj korrupsionit se shumica e sektorëve të tjerë ekonomikë për shkak të madhësisë, kompleksitetit, natyrës shumëvjeçare, kostos së lartë dhe rreziqeve të bashkëlidhura në mjedisin e ndërtuar.¹¹ Në Kosovë, rreth 800 milionë euro të shpenzimeve publike kalojnë çdo vit përmes sistemit të prokurimit, i cili perceptohet se ka parregullsi dhe boshllëqe në disiplinën dhe monitorimin e zyrtarëve publikë.¹² Vlerësimi i Menaxhimit të Investimeve Publike (VMIP) i udhëhequr nga FMN-ja nga viti 2016 dhe një përditësim i vitit 2023 identifikuan nevojën për të forcuar procesin e vlerësimit të projektit, për të përmirësuar ritmin e zbatimit të projektit dhe për të rritur mbështetjen qendrore për projektet kryesore.¹³ VMIP-ja origjinale i referohej një raporti të Auditorit të Përgjithshëm që identifikonte disa rreziqe në Kosovë, duke përfshirë planifikimin e dobët të prokurimit, ndarjen e tenderëve për të shmangur procedurën e hapur të prokurimit, përshtatjen e kriterëve të tenderit në favor të operatorëve të caktuar, dobësitë në vlerësimet e tenderëve dhe lidhjen e kontratave me çmime të ulëta jo normale.¹⁴

Sistemi i prokurimit elektronik të Kosovës¹⁵ përfshin të dhëna dhe dokumente të hapura në të gjithë ciklin e prokurimit, duke përfshirë planet e prokurimit, dosjet e tenderit, kontratat e nënshkruara në formatin PDF, dhe informacione të tilla si ofertuesit, blerësi, furnizuesi, metoda e prokurimit, tenderi dhe vlera e kontratës.¹⁶ Në dhjetor 2021, sistemi kishte 30.500 përdorues,

nga të cilët 11.500 janë kontraktorë dhe 350 janë auditorë dhe u shtua një ndërfaqe e programimit të aplikacionit (NPA) për t'i bërë të dhënat lehtësisht të eksportueshme.¹⁷ Megjithatë, Raporti i Progresit i Komisionit Evropian 2023 vuri në dukje se Kosova duhet të përditësojë sistemin për të siguruar funksionalitetin e tij të plotë dhe për ta sjellë legjislacionin e saj në përputhje me *acquis* të BE-së¹⁸ Qeveria ka shtuar elementë të rinj, duke e bërë të vështirë navigimin për ata që nuk janë ekspertë.¹⁹ Sipas një raporti të Institutit të Kosovës për Drejtësi në gusht 2024, ekziston një nevojë urgjente në Kosovë për një ligj të ri të prokurimit për të siguruar funksionalizimin e plotë të sistemit të prokurimit elektronik.²⁰ Ndërkohë që sistemi i prokurimit elektronik në përgjithësi i bën procedurat e prokurimit të hapura dhe transparente, jo të gjitha modulet e tij, të tilla si menaxhimi i kontratave, përdoren plotësisht nga autoritetet kontraktore.²¹ Plani i veprimit thekson se ka shkelje të vazhdueshme të ligjit ekzistues nga zyrtarët e prokurimit dhe pak dënime për këto shkelje, duke penguar prokurimin publik efikas në Kosovë. Ndërsa sistemi lejon që të bëhen ankesa për të sfiduar çmimet e prokurimit, ai duhet të përditësohet për të garantuar funksionalitetin e tij.²² Mangësitë e tjera janë kapaciteti i kufizuar i Bordit Shqyrtues të Prokurimit (BSHP) për të shqyrtuar dhe trajtuar ankesat në kohë, dhe mungesa e trajnimit të rregullt për gjyqtarët që merren me rastet e korrupsionit në prokurimin publik.

Ky zotim synon të hapë të dhënat në lidhje me të gjitha nivelet e prokurimit publik në një format të lexueshëm nga pajisjet në sistemin e prokurimit elektronik të Kosovës. Pikat kryesore përfshijnë rishikimin e mangësive ekzistuese në sistemin e prokurimit elektronik, miratimin e ndryshimeve në Ligjin për prokurimin publik dhe zhvillimin e rregullave, mjeteve dhe udhëzimeve të reja për sistemin e prokurimit elektronik. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRRPP) është duke mbikëqyrur procesin e ndryshimit të ligjit, së bashku me një grup pune të përbërë nga përfaqësues të institucioneve publike, OSHC-ve, sektorit privat dhe organizatave ndërkombëtare.²³

Potenciali për rezultate: Modest

Miratimi i amendamenteve në Ligjin për Prokurim Publik mund ta sjellë legjislacionin e Kosovës plotësisht në përputhje me Direktivën e BE-së. Projekt-amendamentet nuk janë diskutuar publikisht, por palët e interesuara joqeveritare kanë qasje në të. Është e paqartë nëse ligji i ndryshuar do të kërkojë nga të gjitha autoritetet kontraktore të qeverisë qendrore dhe bashkitë që të publikojnë kontratat e tyre në sistemin e prokurimit elektronik. Sipas Balkan Tender Watch, ndryshimet do ta vendosin KRRPP-në në kuadër të Ministrisë së Financave, duke reduktuar kështu pavarësinë e saj institucionale.²⁴ Për më tepër, BSHP-ja do të transformohet në një organ të një niveli, pa të drejtë ankese ndaj vendimeve të saj, gjë që do të ndikonte negativisht në prokurimin publik në Kosovë.²⁵ Për shkak të mungesës së informacionit për ndryshimet e parapara në ligjin e ndryshuar, MPR-ja e vlerëson potencialin për rezultate si modest.

Mundësitë, sfidat dhe rekomandimet gjatë zbatimit

Ndryshimet në Ligjin për Prokurim Publik janë në zhvillim e sipër që nga viti 2020. Sipas një përfaqësuesi të shoqërisë civile, ndryshimet janë në rrugën e duhur për t'u miratuar nga parlamenti deri në fund të vitit 2024. Që nga viti 2020, qeveria e ka shtyrë vazhdimisht miratimin e ligjit të ndryshuar.²⁶ Për më tepër, qeveria do të duhet gjithashtu të përgatisë legjislacionin dytësor për ligjin e amenduar, pasi ai të miratohet.

MPR-ja rekomandon që gjatë zbatimit të kryhen hapat e mëposhtëm:

- Sigurimi i trajtimit transparent të ankesave nga BSHP-ja. Për shembull, Shqipëria ka krijuar një sistem elektronik për të mundësuar furnitorët të paraqesin ankesa në internet dhe që agjencia e prokurimit të menaxhojë procesin në mënyrë digjitale dhe të hapur.²⁷
- Bëjini të dhënat për sistemin e prokurimit elektronik të ndërveprueshme me bazat e tjera të të dhënave, veçanërisht me Sistemin Informativ të Financave të Kosovës (SIMFK) të përdorur nga Ministria e Financave, portali kombëtar i të dhënave të hapura (Zotimi 2.2) dhe bazën e të dhënave të planifikuar për financat politike (Zotimi 4.3).
- Sigurohuni që të dhënat e publikuara përmes sistemit të prokurimit elektronik t'i përmbahen Standardit të të Dhënave të Kontratës së Hapur (SDHKH). Kosova gjithashtu mund të punojë me Nismën për Transparencë të Infrastrukturës (NTI) dhe Partneritetin Kontraktues të Hapur (PKH) për të miratuar Standardin e Kontratës së Hapur për të Dhënat e Infrastrukturës, i cili vendos praktikën më të mira për të dhënat e hapura dhe zbulimin e të dhënave në prokurimin publik të lidhur me infrastrukturën.²⁸
- Zbuloni pronësinë përfituese për kompanitë që marrin kontrata të prokurimit publik.

Zotimi numër 4.3: Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe kontrollit financiar të partive politike të regjistruara në Republikën e Kosovës.

(Zyra e Kryeministrit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikimin, Agjencia Kundër Korrupsionit)

Për një përshkrim të plotë të këtij zotimi, shih Zotimin 4.1 në planin e veprimit [këtu](#).

Konteksti dhe objektivat

Ky zotim synon të rrisë transparencën, llogaridhënien dhe kontrollin financiar të partive politike. Legjislativi i Kosovës është kryesisht në përputhje me standardet përkatëse të BE-së, OSBE-së dhe Këshillit të Evropës, por ka një mbikëqyrje të dobët të financimit të partive politike.²⁹ Rreth 4 milionë euro fonde publike ndahen për partitë politike në Kosovë çdo vit, përveç financimit të drejtpërdrejtë nga qytetarët dhe personat juridikë. Korniza ligjore për këto transaksione përbëhet nga Ligji për Financimin e Partive Politike (LFPP) dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZGJ). Arsyet për vënien e gjobave janë të përcaktuara keq dhe gjobat janë "jashtëzakonisht të ulëta" dhe nuk ndalojnë përdorimin e parave të gatshme.³⁰ Ndryshimet në LFPP në vitin 2022 i dhanë Zyrës për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike një mandat për të monitoruar financat e partive politike *ad hoc* dhe çdo vit përmes raporteve të pavarura të auditimit. Sipas Transparency International (TI), auditorët vazhdimisht theksojnë çështje të përhapura në financat e partive politike, duke përfshirë praktikën joadekuate të kontabilitetit, procedurat e pamjaftueshme të tenderimit, mosrespektimin e detyrimeve tatimore, mungesën e masave të kontrollit të brendshëm dhe mungesën e njohurive kontabël midis zyrtarëve financiarë.³¹ TI-ja gjithashtu vëren se vonesat në proceset e auditimit prej tre deri në katër vjet shpesh pengojnë publikimin e raporteve brenda afateve ligjore. Kjo e fundit u ndryshua në ndryshimet e vitit 2022 në LFPP, duke lejuar që raportet të publikohen brenda afateve ligjore, pavarësisht nëse ato ishin audituar. Raportet disponohen vetëm si skedarë PDF të skanuar. OSHC-të si Lëvizja FOL ka avokuar për përmirësime të mëtejshme, siç është ndalimi i përdorimit të parave të gatshme.³²

Edhe pse ndryshimet e vitit 2022 në LFPP ishin në përputhje me Opinionin e Komisionit të Venecias, ka sfida të vazhdueshme në respektimin e ligjit në financimin transparent të partive dhe fushatave. TI-ja raporton se raportimi i pasaktë shpeshherë shkon i paligjshëm nga Zyra për Kontroll Financiar, për shkak të mungesës së burimeve dhe stafit në Zyrë.³³ Përveç kësaj,

Instituti i Kosovës për Drejtësi ka raportuar në vitin 2024 se shumica e subjekteve politike nuk kanë rregulla të kontrollit të brendshëm financiar, dhe shumë burime të të hyrave dhe shpenzimeve nuk raportohen.³⁴

Zotimi u identifikua përmes procesit të bashkë-krijimit me inute nga TI Kosovë dhe OJQ të tjera në KKK.³⁵ Megjithatë, zotimi fillimisht ishte përjashtuar në draft-planin e veprimit për shkak të ndryshimeve në pritje të LFPP në vitin 2022.³⁶ Ky vendim u rishikua në mesin e vitit 2023 kur u bë e qartë se ligji i ri nuk trajtonte në mënyrë të gjithanshme çështjet që lidhen me publikimin e raporteve financiare të partive politike. Pika e kontaktit me PQH-në ndau me KKK-në draftin përfundimtar të planit të veprimit para dorëzimit të tij në Qeverinë e Republikës së Kosovës për miratim, i cili përfshinte këtë zotim.³⁷

Piketat parashikojnë publikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të partive politike në formatin e të dhënave të hapura në një platformë të re online, monitorimin e këtyre të dhënave gjatë ciklit zgjedhor 2025 në nivel qendror dhe lokal dhe kryerjen e një fushate avokimi me përfshirjen e shoqërisë civile dhe medias, për të raportuar keqpërdorim të mundshëm të financimit politik. Zotimi adreson vlerën e transparencës në PQH, pasi platforma online do t'i bëjë më të qasshme për publikun të dhënat për financat e partive politike.

Potenciali për rezultate: Modest

Ky zotim mund të përmirësojë transparencën e financave të partive politike nëse partitë politike prodhojnë dokumentacion më të plotë dhe e ngarkojnë atë në platformë. Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, si dhe OJQ-të dhe publiku, mund të përdorin platformën për të identifikuar parregullsitë që tregojnë mashtrime ose abuzime të mundshme, siç është përdorimi i donacioneve politike nga flukset e paligjshme financiare. Sondazhet e kryera nga Barometri i Sigurisë së Ballkanit Perëndimor në vitin 2022 zbuluan se partitë politike janë ndër institucionet më pak të besueshme nga publiku në Kosovë.³⁸ Financimi transparent politik mund të rrisë besimin e publikut në institucionet qeveritare dhe në rezultatet e zgjedhjeve në Kosovë, siç janë zgjedhjet parlamentare të shkurtit 2025. Ka lidhje të drejtpërdrejta me Zotimin 4.1 për prokurimin publik për të parandaluar që kontratat, për shembull, të drejtohen drejt kompanive të lidhura politikisht, dhe në një nivel më të gjerë, me zotimet për të dhënat e hapura (Zotimet 2.1-2.4). Zotimi adreson kornizën e dobët ligjore përmes një ndryshimi tjetër dhe vendosjes së mekanizmave që do të forconin mbikëqyrjen.

Një përfaqësues i shoqërisë civile vuri në dukje se publikimi i informacionit në formatin e të dhënave të hapura do të ishte një përmirësim i rëndësishëm në praktikën e mëparshme të partive politike që dorëzonin raportet e tyre financiare në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) si skedarë PDF të skanuar.³⁹ Partitë politike në Kosovë përfshijnë në raportet e tyre emrat e donatorëve, shumat e donacioneve, datat e donacionit, asetet dhe detyrimet, donacionet në natyrë dhe shpenzimet individuale (ato mbi 5000 euro).⁴⁰ Megjithatë, informacioni aktualisht nuk është publikuar në mënyrë që të jetë e përshtatshme për shkarkime me shumicë.

Duke pasur parasysh mungesën e proceseve të brendshme dhe pajtueshmërinë nga partitë, ekziston rreziku i mospërputhjes së vazhdueshme me rregulloret ekzistuese për raportimin e financave politike, me pak nxitje ose sanksione për të ndryshuar sjelljen. Ndërkohë që krijimi i një platforme digjitale është një hap pozitiv, ka të ngjarë të ketë vetëm një potencial modest për rezultate nëse çështjet e tjera nuk adresohen.

Mundësitë, sfidat dhe rekomandimet gjatë zbatimit

Sipas Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2023, LFPP-së së ndryshuar i mungon kërkesa për raportim të përkohshëm të të ardhurave dhe shpenzimeve të kandidatëve politikë gjatë periudhave të fushatës.⁴¹ Përveç kësaj, Instituti Demokratik i Kosovës thekson se ligji gjithashtu nuk e rregullon qartë vetëfinancimin e kandidatëve, fushatën e palëve të treta dhe fushatën digjitale (d.m.th. përmes rrjeteve sociale), duke i bërë këto lloj financash të cenueshme ndaj korrupsionit dhe abuzimit.⁴² Gjatë ndryshimit të kornizës ligjore për kontrollin e financimit politik, Kosova mund të marrë parasysh rregulloret për vetëfinancimin e kandidatëve, fushatat digjitale dhe fushatat e palëve të treta.

Gjatë zbatimit të këtij zotimi MPR-ja rekomandon kryerjen e hapave të mëposhtëm:

- Sigurimin që të dhënat të publikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe në kohë, duke përfshirë edhe para zgjedhjeve (d.m.th. përpara ciklit zgjedhor të vitit 2025).
- Bërjen e dhënave të financave politike të ndërveprueshme me baza të ndryshme të dhënash për monitorim më të mirë kundër korrupsionit. Për shembull, lidhja e platformës së financave politike me sistemin e prokurimit elektronik mund të ndihmojë në identifikimin kur kontratat e prokurimit publik drejtohen drejt kompanive të lidhura politikisht.
- Konsultimin me përdoruesit (d.m.th. studiuesit dhe gazetarët) për t'u siguruar që të dhënat në platformë janë të dobishme.
- Krijimin e një mekanizmi ankesash në platformën për OJQ-të, gazetarët dhe publikun për të shënuar rastet e dyshimta të financimit politik për hetim.
- Sigurimin që Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike të ketë burime dhe staf të mjaftueshëm për të monitoruar dhe audituar raportet e financimit politik.
- Përfshirja e informacioneve se si Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike gjurmon veprimet detyruese të ndërmarra kundër partive politike, kandidatëve ose aktivistëve të palëve të treta për shkelje të LFPP-së dhe rregulloreve të tjera të financave politike.
- Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike mund të integrojë platformën e re në trajnimet ekzistuese për subjektet politike në lidhje me raportimin financiar, llogaritjen dhe auditimin.⁴³ Zyra gjithashtu mund të trajtojë anëtarët e publikut, OJQ-të dhe gazetarët se si të përdorin të dhënat e financave politike.

Zotime të tjera

Zotime të tjera që MPR-ja nuk i identifikoi si zotime premtuese diskutohen më poshtë. Ky rishikim ofron rekomandime për të kontribuar në mësimin dhe zbatimin e këtyre zotimeve.

Nën **Zotimi 1.1**, Qeveria do të shtojë një seksion në portalin e-Kosova për të digjitalizuar procesin e aplikimit për grante dhe subvencione shtetërore.⁴⁴ Sipas planit të veprimit, Qeveria e Kosovës ndan më shumë se 300 milionë euro çdo vit në grante dhe subvencione për individë, biznese dhe OJQ. Indeksi i qëndrueshmërisë së OSHC-ve i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ka vënë në dukje se këto procese në përgjithësi nuk janë transparente dhe OJQ-të që janë kritike ndaj politikave dhe vendimeve të qeverisë rrallë aplikojnë për financim publik.⁴⁵ Seksioni i ri për e-Kosova do t'u mundësojë përdoruesve të aplikojnë për grante online. Ai gjithashtu do të ofrojë informacion publik për zbatimin e

granteve dhe subvencioneve të dhëna, informacion për përfituesit e secilës thirrje për grante e subvencione, si dhe raporte vlerësimi. Për të siguruar një shpërndarje konkurruese dhe transparente të financimit, MPR-ja rekomandon trajnimin jo vetëm të zyrtarëve publikë, por edhe të OJQ-ve për mënyrën e aplikimit dhe për sigurimin e informacionit të kërkuar për grantet dhe subvencionet e dhëna. Gjithashtu, MPR-ja rekomandon krijimin e standardeve të unifikuara të monitorimit dhe raportimit, me kontributin e OSHC-ve dhe organizatave ndërkombëtare, për transparencë dhe efektivitet më të mirë të fondeve të shpenzuara.

Nën **Zotimi 1.2**, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) synon të integrojë modulën e quajtur e-Komunat në e-Kosova me 50 shërbime komunale. Moduli gjithashtu do të ofrojë qasje në kohë reale në buxhetet dhe të hyrat komunale, të dhëna të hapura dhe interaktive, kontraktime të hapura, plane urbanistike, leje ndërtimi dhe informacion mbi procesin e vlerësimit të ligjshmërisë së akteve komunale. Shoqëria civile dhe palët e interesuara qeveritare të intervistuar besojnë se ky zotim mund të ndihmojë në adresimin e korrupsionit të përhapur në nivel lokal. Sipas një studimi të vitit 2022 të Institutit GAP për Studime të Avancuara, nga 38 komunat në Kosovë, vetëm 15 kanë publikuar të gjitha dokumentet e kërkuara lidhur me buxhetin.⁴⁶ Ky zotim mund të rrisë qasjen e publikut në informatat buxhetore komunale, nëse të gjitha komunat publikojnë informatat buxhetore për e-Komunat.

MAPL-ja publikoi e-Komunat në maj 2024 dhe aktualisht është në fazën e tretë të zbatimit. Deri më tani ka këto shërbime: transmetime të drejtpërdrejta të mbledhjeve të kuvendeve komunale, raportim për problemet e komunave, komunikim me zyrtarët komunalë, nisjen dhe kontributin në debate publike për politikën në komuna, dhe informim për pasurinë e zyrtarëve komunalë.⁴⁷ Gjatë pjesës së mbetur të periudhës së zbatimit, MPR-ja rekomandon publikimin e informacionit buxhetor në formatin e hapur të të dhënave. MAPL-ja mund të shikojë shembuj nga vendet e tjera në lidhje me transparencën fiskale për qeveritë lokale. Për shembull, Lituania ka një portal ku bashkitë publikojnë të dhëna në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet shtetërore dhe vendore, borxhet dhe papunësinë.⁴⁸ Gjithashtu, Estonia ka një portal të së dhënave buxhetore që përfshin raporte mujore mbi shpenzimet dhe informacionin e kontabilitetit të komunave, si dhe agjencive dhe kompanive shtetërore dhe komunale.⁴⁹

Për **Zotimin 1.3**, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural synon të zhvillojë një sistem online për qytetarët për të raportuar dhe vlerësuar dëmet nga fatkeqësitë natyrore. Pasi të publikohet, MPR-ja rekomandon rritjen e ndërgjegjësimit për të promovuar sistemin, veçanërisht në mesin e demografisë së synuar (d.m.th. fermerët).

Zotimet 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 trajtojnë të dhënat e hapura. Që nga qershori 2024, portali i të dhënave të hapura të Kosovës përmban 205 grupe të dhënash nga 14 organizata.⁵⁰ Kosova miratoi Kartën Ndërkombëtare të së Dhënave të Hapura (KDHH) në vitin 2016, por ka bërë përparim të kufizuar në zbatimin e parimeve të KDHH-së.⁵¹ Zotimi 2.1 synon të krijojë një Këshill Strategjik Kombëtar për të mbikëqyrur zbatimin e KDHH-së dhe një grup pune ndërinstucional brenda qeverisë për të koordinuar zbatimin e KDHH-së.⁵² Zotimi 2.2 synon të rrisë numrin e grupeve të së dhënave në portalin e të dhënave të hapura me 30 për qind. Zotimet 2.3 dhe 2.4 synojnë të ofrojnë asistencë teknike për zyrtarët publikë të ngarkuar me publikimin e të dhënave të hapura dhe të rrisin ndërgjegjësimin e nëpunësve civilë për të dhënat e hapura. Këto zotime mund të ofrojnë bazat për rritjen e sasisë së të dhënave të publikuara në portal dhe mund ta afrojnë Kosovën me *acquis* të BE-së mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.⁵³ Megjithatë, atyre u mungon qartësia mbi

ndryshimet e parashikuara në praktikën e të dhënave të hapura. Për shembull, Zotimi 2.1 nuk jep detaje mbi rolin e Këshillit Strategjik Kombëtar në mbikëqyrjen e parimeve të KDHH-së, dhe Zotimi 2.2 nuk përmend kategoritë e të dhënave që do të shtohen në portal. Gjatë zbatimit MPR-ja rekomandon kryerjen e hapave të mëposhtëm:

- Pajtimin për mandatin dhe procedurat e punës për Këshillin Strategjik Kombëtar që përcakton rolin e vet në monitorimin e zbatimit të KDHH-së.
- Konsultimi me përdoruesit e të dhënave për të përcaktuar se cilat grupe të dhënash do të publikohen për Zotimin 2.2.
- Shtimi i një faqe komentesh në portalin e të dhënave të hapura për përdoruesit që të propozojnë grupe të reja të dhënash për publikim dhe të raportojnë grupe të dhënash të munguara ose të paplota.
- Publikimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe gjeografisë që janë gjithashtu të ndërveprueshme ndërmjet niveleve të qeverisjes dhe ndërmjet agjencive qeveritare.
- Ofrimi i mbështetjes teknike për komunat që të publikojnë të dhënat e tyre në portalin e të dhënave të hapura dhe nxitja e miratimit të parimeve të KDHH-së nga qeveritë komunale.
- Dhënia përparësi grupeve të të dhënave të etiketuara "me vlerë të lartë" në Direktivën e BE-së për të Dhënat e Hapura 2019.⁵⁴
- Dhënia e prioritetit grupeve të të dhënave për monitorimin kundër korrupsionit që janë të lidhura me zotime të tjera në planin e veprimit, si prokurimi publik (Zotimi 4.1) dhe financimi politik (Zotimi 4.3).

Zotimi 3.1 synon të përmirësojë kapacitetin e zyrtarëve publikë për t'u konsultuar me publikun në proceset vendimmarrëse në nivel kombëtar dhe komunal. Ai përfshin ndihmën e zyrtarëve publikë se si të ndjekin rregulloret ekzistuese mbi konsultimet, promovimin e platformave ekzistuese qeveritare për konsultime publike dhe angazhimin e të rinjve në vendimmarrje. Kosovës i mungon një traditë e angazhimit të drejtpërdrejtë në proceset vendimmarrëse, përkundër obligimit ligjor të institucioneve publike për të përfshirë qytetarët.⁵⁵ Ekziston një platformë për konsultime, por ajo është e pashfrytëzuar dhe nuk lehtëson angazhimin.⁵⁶ Angazhimi nuk përcakton mekanizmat për pjesëmarrje, ndaj rezultatet mund të mos i atribuohen zbatimit të pikëarritjeve të zotimit. MPR-ja rekomandon gjatë zbatimit përdorimin e metodave të ndryshme të angazhimit për fusha të ndryshme të politikave, siç është buxheti me pjesëmarrje (veçanërisht në nivel komunal). Qeveria mund të zhvillojë gjithashtu një strategji se si të arrijë grupet e nënpërfaqësuar për pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse.

Zotimi 3.2 fokusohet në parandalimin e përhapjes së padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (PSKPP).⁵⁷ PSKPP-të janë një problem në rritje në Kosovë.⁵⁸ Ky zotim kërkon transpozimin e Direktivës Anti-PSKPP të BE-së 2024,⁵⁹ organizimin e tryezave të rrumbullakëta dhe konferencave mbi PSKPP-të, dhe mbështetjen e shoqërisë civile në fushatat kundër PSKPP-së. Duke qenë se ky zotim synon të mbështesë lirinë e fjalës dhe lirinë e medias, është i rëndësishëm për pjesëmarrjen qytetare. Direktiva kërkon që shtetet anëtare të BE-së të ofrojnë të dhëna statistikore vjetore për rastet PSKPP (p.sh., numrin e PSKPP-ve, numrin e procedurave gjyqësore të klasifikuara sipas llojit të të paditurve dhe të paditësit, dhe llojin e padisë së paraqitur). Ajo gjithashtu kërkon futjen e dënimeve proporcionale dhe zhbindëse për iniciatorët e PSKPP-së dhe dispozita ligjore që lejojnë gjykatat dhe tribunat të pushojnë PSKPP-të në fazën më të hershme të mundshme në procedurat ligjore, në përputhje me ligjin kombëtar.

Kosova gjithashtu mund të marrë parasysh masat për të mundësuar mbulimin e shpenzimeve ligjore të bëra nga të paditurit që përballen me PSKPP-të.

Zotimi 3.3 synon të krijojë mekanizma që qytetarët të dërgojnë komente tek institucionet publike. Zotimi nuk përcakton specifikimet e mekanizmit të reagimit, por përmend mundësinë e një aplikacioni celular. MPR-ja rekomandon marrjen e masave për të nxitur institucionet publike që t'i përgjigjen reagimeve në punën e tyre, duke përfshirë veprimet korigjuese.

Zotimi 4.2 synon të rrisë transparencën e rekrutimit të zyrtarëve të nivelit të lartë.⁶⁰ Ai përfshin publikimin e udhëzimeve për procedurat e rekrutimit, hapjen e një platforme online për rekrutimin e zyrtarëve të nivelit të lartë dhe publikimin e procesverbaleve të intervistave të kandidatëve. Kompetencat e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit përfshijnë, ndër të tjera, parandalimin e konfliktit të interesit në shërbimin civil. Një studim i Grupit të Kërkimit të Politikave të Ballkanit zbuloi se proceset e rekrutimit dhe promovimit për pozitat në sektorin publik në Kosovë janë shumë të politizuara, ku besnikëria partiake shpesh ka prioritet mbi kapacitetin profesional.⁶¹ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2023 vuri në dukje përdorimin e gjerë të pozitave të ushtruesit të detyrës në shërbimin civil në Kosovë, veçanërisht në nivelet e larta, si dhe procedurat joefektive të rekrutimit të jashtëm për menaxhmentin e lartë.⁶² Ky zotim mund të ndihmojë në uljen e favorizimit dhe klientelizmit në sektorin publik duke e bërë procesin e rekrutimit më transparent dhe meritokratik. MPR-ja rekomandon publikimin e informacionit të detajuar për vendet e lira të punës, të tilla si kualifikimet e kërkuara dhe përvojën e punës, kush mund të aplikojë, fazat e procesit të përzgjedhjes dhe mënyrat e pranuar për të vërtetuar kualifikimet. MPR-ja rekomandon gjithashtu që të sigurohet që publikimi i vendimeve për kandidatët nga anëtarët e paneleve intervistuese të jetë i lehtë për t'u kuptuar nga publiku.

⁹ FMN, Republika e Kosovës, Raporti për Vendin i FMN-së Nr. 23/372, Nëntor 2023.

¹⁰ Banka Botërore, Rishikimi i Shpenzimeve Publike, Mars 2023, Aktivitetet e ndërtimit përfaqësonin mbi gjysmën e investimeve të sektorit privat në Kosovë në vitin 2022.

¹¹ Shih, për shembull, Wells, Korrupsioni dhe marrëveshjet e fshehta në ndërtim: një pamje nga industria, 2013, <https://www.elgaronline.com/edcollchap/edcoll/9781782544401/9781782544401.00010.xml> dhe <https://finintegrity.org/corruption-in-construction/>

¹² Fidan Kajala (Pika e Kontaktit, Qeveria e Kosovës), intervistë e kryer nga MPR-ja, 23 maj dhe 24 qershor 2024.

¹³ FMN, Republika e Kosovës, Raporti për Vendin i FMN-së Nr. 23/380, Dhjetor 2023.

¹⁴ FMN, Republika e Kosovës, Raporti i Asistencës Teknike të FMN-së – Vlerësimi i Menaxhimit të Investimeve Publike, Raporti i FMN-së për Vendin nr. 16/100.

¹⁵ Republika e Kosovës, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=327>

¹⁶ Partneritet i hapur kontraktues, organizimi për sukses: Të dhënat dhe mbikëqyrja publike për prokurim publik më transparent në Kosovë, 14 dhjetor 2021, <https://www.open-contracting.org/2021/12/14/setting-up-for-success-data-and-public-oversight-for-more-transparent-public-procurement-in-kosovo/>

¹⁷ Partneritet i hapur kontraktues, organizimi për sukses: Të dhënat dhe mbikëqyrja publike për prokurim publik më transparent në Kosovë, 14 dhjetor 2021, <https://www.open-contracting.org/2021/12/14/setting-up-for-success-data-and-public-oversight-for-more-transparent-public-procurement-in-kosovo/>

¹⁸ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2023, f. 72, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?filename=SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf

¹⁹ Blerta Taçi (Open Data Kosovo), intervistë e kryer nga MPR-ja, 23 maj 2024.

²⁰ Koalicioni i UNCA-s, raporti i shoqërisë civile, f. 9, <https://uncaccoalition.org/wp-content/uploads/FINAL-Kosovo-parallel-report-on-UNCAC-implementation-Kosovo-Law-Institute-UNCAC-Coalition-22-August-2024-1.pdf>

²¹ Koalicioni i UNCA-s, raporti i shoqërisë civile, f. 45, <https://uncaccoalition.org/wp-content/uploads/FINAL-Kosovo-parallel-report-on-UNCAC-implementation-Kosovo-Law-Institute-UNCAC-Coalition-22-August-2024-1.pdf>

- ²² Komisioni Evropian, Raporti i Kosovës 2023, f. 27, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?filename=SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf
- ²³ Fidan Kajala (Pika e Kontaktit, Qeveria e Kosovës), korrespondencë me MPR-në, 24 qershor 2024.
- ²⁴ Shih Balkan Tender Watch, Raporti në hije mbi prokurimin publik në Kosovë 2023, <https://balkantenderwatch.eu/local/uploaded/BIH%20local/Shadow%20report%20KOS%20web.pdf>
- ²⁵ Balkan Tender Watch, raport në hije për prokurimin publik në Kosovë 2023, <https://balkantenderwatch.eu/local/uploaded/BIH%20local/Shadow%20report%20KOS%20web.pdf>
- ²⁶ Koalicioni i UNCA-s, raporti i shoqërisë civile, f. 9, <https://uncaccoalition.org/wp-content/uploads/FINAL-Kosovo-parallel-report-on-UNCAC-implementation-Kosovo-Law-Institute-UNCAC-Coalition-22-August-2024-1.pdf>
- ²⁷ Partneriteti i hapur kontraktues, Si redukton burokracinë për furnitorët e qeverisë sistemi i ankesave elektronike në Shqipëri, 22 nëntor 2022, <https://www.open-contracting.org/2022/11/22/how-albanias-e-complaints-system-reduces-red-tape-for-government-suppliers/>
- ²⁸ CoST, Iniciativa për Transparencën e Infrastrukturës, OC4IDS – një standard i ri për transparencën e infrastrukturës, 16 prill 2019, <https://infrastructuretransparency.org/resource/oc4ids-a-new-standard-for-infrastructure-transparency/>
- ²⁹ Zvekić, U, Roksandić, S. dhe Dobovšek, B, Korrupsioni i Organizuar = Financimi politik në Ballkanin Perëndimor, Iniciativa Globale kundër Krimit Transnacional, Qershor 2023.
- ³⁰ Po aty; Burbuqe Kastrati dhe Mexhide Demolli (FOL), intervistë e kryer nga MPR-ja, 24 qershor 2024.
- ³¹ Transparency International, Midis reformës kundër korrupsionit dhe rënies, 2024, https://images.transparencycdn.org/images/2024_NISReport_BetweenAnti-CorruptionReformAndDecline_English.pdf
- ³² Po aty; Burbuqe Kastrati dhe Mexhide Demolli (FOL), intervistë e kryer nga MPR-ja, 24 qershor 2024.
- ³³ Transparency International, Midis reformës kundër korrupsionit dhe rënies, f. 36, https://images.transparencycdn.org/images/2024_NISReport_BetweenAnti-CorruptionReformAndDecline_English.pdf
- ³⁴ Koalicioni i UNCA-s, raporti i shoqërisë civile, f. 31, <https://uncaccoalition.org/wp-content/uploads/FINAL-Kosovo-parallel-report-on-UNCAC-implementation-Kosovo-Law-Institute-UNCAC-Coalition-22-August-2024-1.pdf>
- ³⁵ Fidan Kajala (Pika e Kontaktit, Qeveria e Kosovës), intervistë e kryer nga MPR-ja, 23 maj dhe 24 qershor 2024.
- ³⁶ Drafti i mëparshëm përfshinte një agazhim për: Rritja e transparencës së sistemit gjyqësor dhe prokurorial (Burbuqe Kastrati dhe Mexhide Demolli (FOL), intervistë e kryer nga MPR-ja, 24 qershor 2024).
- ³⁷ Fidan Kajala (PeK), korrespondencë me MPR-në, 25 qershor 2024.
- ³⁸ WBSB, Perceptimi publik mbi besimin, korrupsionin dhe integritetin e institucioneve publike në Kosovë, 2022, https://qkss.org/images/uploads/files/WBSB_2022_Kosovo_Report_1_Dec_2022_ENG.pdf
- ³⁹ Burbuqe Kastrati (FOL), korrespondencë me MPR-në, 31 korrik 2024.
- ⁴⁰ Transparency International, Sjellja e faturave, f. 24, https://images.transparencycdn.org/images/2023_WorkingPaper_BringingTheReceipts_English.pdf
- ⁴¹ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2023, f. 29, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?filename=SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf
- ⁴² Instituti Demokratik i Kosovës, Financimi politik në Kosovë, dhjetor 2022, f. 20, <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2022/12/47-Raport-Political-Financing-Kosovo-Eng-02.pdf>
- ⁴³ Instituti Demokratik i Kosovës, Financimi politik në Kosovë, dhjetor 2022, f. 15, <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2022/12/47-Raport-Political-Financing-Kosovo-Eng-02.pdf>
- ⁴⁴ Qeveria publikoi e-Kosova, një portal kombëtar për shërbime digjitale, në vitin 2016, <https://ekosova.rks-gov.net/>
- ⁴⁵ 2020 Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile, Kosovë, Shtator 2021, f. 8, <https://storage.googleapis.com/cso-si-dashboard.appspot.com/Reports/CSOSI-Kosovo-2020.pdf>
- ⁴⁶ Instituti Gap, Indeksi i Transparencës së Buxhetit Komunal 2022, Gusht 2023, https://www.institutigap.org/documents/46078_2022%20Municipal%20Budget%20Transparency%20Index.pdf
- ⁴⁷ Zyra e Kryeministrit, Publikon platformën e-Komuna, 17 maj 2024, <https://kryeministri.rks-gov.net/en/blog/the-e-komuna-platform-is-launched-it-facilitates-citizens-access-to-municipal-services/>
- ⁴⁸ Hapni buxhetet e financave, shtetërore, komunale dhe fonde të Lituaniës, <https://lietuvosfinansai.lt/en/lituanian-finance-2/>
- ⁴⁹ <https://saldo.rtk.ee/saldo-app/aruanded?search=%257B%2522code%2522:null,%2522name%2522:null,%2522year%2522:21,%2522period%2522:%252212%2522,%2522lastUsedPartnerNameSearch%2522:%2522%2522%257D>
- ⁵⁰ Republika e Kosovës, Të dhënat e hapura, sipas përditësimit të fundit nga qershori 2024, <https://web.archive.org/web/20240608223147/https://opendata.rks-gov.net/dataset>
- ⁵¹ Fidan Kajala (Pika e Kontaktit, Qeveria e Kosovës), Blerta Thaçi (Drejtoresh Ekzekutive, Open Data Kosovo), intervistë e kryer nga MPR-ja, 23 maj 2024; Burbuqe Kastrati dhe Mexhide Demolli (FOL), intervistë e kryer nga MPR-ja, 24 qershor 2024; dhe Open Data Kosovo, Drejt Qeverisjes së Hapur në Kosovë, 31 maj 2021, <https://opendatakosovo.medium.com/towards-open-government-kosovo-57f295f9675a>

⁵² Shih KDHH, <https://opendatacharter.org/government-adopters/>. International ODC (KDHH) është një organizatë ndërkombëtare për bashkëpunimin ndërmjet qeverive dhe organizatave, që punon për të hapur të dhëna bazuar në një grup të përbashkët prej gjashtë parimesh: 1) e hapur si parazgjedhje, 2) në kohë dhe gjithëpërfshirëse, 3) e aksesueshme dhe e përdorshme, 4) e krahasueshme dhe e ndërveprueshme, 5) për përmirësimin e qeverisjes dhe zotimit të qytetarëve, dhe 6) për zhvillim dhe inovacion gjithëpërfshirës.

⁵³ Burbuqe Kastrati dhe Mexhide Demolli (FOL), intervistë e kryer nga MPR-ja, 24 qershor 2024.

⁵⁴ Bashkimi Evropian, Direktiva (BE) 2019/1024 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 qershor 2019 për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1561563110433&uri=CELEX:32019L1024>

⁵⁵ Fidan Kajala (Pika e Kontaktit, Qeveria e Kosovës), intervistë e kryer nga MPR-ja, 23 maj dhe 24 qershor 2024.

⁵⁶ Republika e Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, <https://eparticipimi.opendatakosovo.org/issues>

⁵⁷ PSKPP-të janë padi shqetësuese që synojnë gazetarët, të cilat janë ngritur me pak ose aspak shanse suksesi dhe zakonisht kërkojnë një shumë joproportionale për dëmet.

⁵⁸ SafeJournalists, Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve të Ballkanit Perëndimor 2022 Raporti Narrativ – Kosovë.

⁵⁹ Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, Direktiva (BE) 2024/1069 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 Prill 2024, https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=OJ:L_202401069

⁶⁰ Burbuqe Kastrati dhe Mexhide Demolli (FOL), intervistë e kryer nga MPR-ja, 24 qershor 2024.

⁶¹ Grupi Hulumtues i Politikave Ballkanike, Reforma e Administratës Publike në Kosovë: Lufta e vazhdueshme për t'ia dalë, 2020, <https://balkansgroup.org/en/public-administration-reform-in-kosovo-constant-struggle-to-make-it/>

⁶² Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2023, f. 13, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?filename=SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf

Pjesa III. Metodologjia dhe Treguesit e MPR-së

Qëllimi i këtij rishikimi nuk është vlerësimi. Ai synon të jetë një rishikim i shpejtë, i pavarur dhe teknik i karakteristikave të planit të veprimit dhe pikave të forta dhe sfidave që MPR-ja identifikon për të informuar një proces më të fortë të zbatimit. MPR-ja nënvizon zotimet që kanë potencialin më të lartë për rezultate, një prioritet të lartë për palët e interesuara të vendit, një prioritet në kontekstin e qeverisjes së hapur kombëtare ose një kombinim të këtyre faktorëve.

Tre produktet e MPR-së të ofruara gjatë një cikli të planit kombëtar të veprimit përfshijnë:

- **Përmbledhjen e bashkë-krijimit:** Një përmbledhje koncize që thekson mësimet nga raportet e mëparshme të MPR-së për të mbështetur procesin e PQH-së të një vendi, hartimin e planit të veprimit dhe mësimin e përgjithshëm.
- **Rishikimin e Planit të Veprimit:** Një rishikim teknik i karakteristikave të planit të veprimit dhe pikave të forta dhe sfidave që MPR-ja identifikon për të informuar një proces më të fortë të zbatimit.
- **Raportin e rezultateve:** Një vlerësim i përgjithshëm i zbatimit që përqendrohet në rezultatet e nivelit të politikave dhe mënyrën se si ndodhin ndryshimet. Ai gjithashtu kontrollon pajtueshmërinë me rregullat e PQH-së dhe informon llogaridhënien dhe mësimin në një periudhë afatgjatë.

Në Rishikimin e Planit të Veprimit, MPR-ja ndjek një proces filtrimi dhe grupimi për të identifikuar reformat ose zotimet premtuese:

Hapi 1: Përcakton se çfarë është e rishikueshme bazuar në verifikueshmërinë e zotimit siç është shkruar në planin e veprimit.

Hapi 2: Përcakton nëse zotimi ka një lente të hapur qeveritare. A është e rëndësishme për vlerat e MPR-së?

Hapi 3: Rishikon zotimet që janë të verifikueshme dhe kanë një lente të hapur qeveritare për të identifikuar nëse një zotim i caktuar duhet të bashkohet. Zotimet që kanë një objektiv të përbashkët të politikës ose kontribuojnë në të njëjtën reformë ose çështje politike duhet të grumbullohen. Potenciali për rezultatet e zotimeve të grupuara duhet të rishikohet në tërësi. Stafi i MPR-së ndjek këto hapa për të grupuar zotimet:

- a. Përcaktimi i temave kryesore. Nëse plani i veprimit nuk është tashmë i grupuar sipas temave, stafi i MPR-së mund të përdorë etiketimin tematik të PQH-së si referencë.
- b. Rishikimi i objektivave të zotimeve për të identifikuar zotimet që adresojnë të njëjtën çështje të politikës ose kontribuojnë në të njëjtën politikë më të gjerë ose reformën e qeverisë.
- c. Organizimi i zotime në grupimeve sipas nevojës. Zotimet mund të organizohen tashmë në planin e veprimit sipas politikave specifike ose reformave të qeverisë.

Hapi 4: Hapi vlerësimi i potencialit për rezultate të grupit ose zotimit të pavarur.

Filtrimi është një proces i brendshëm. Të dhënat për zotimet individuale gjenden në Shtojcën 1. Për më tepër, gjatë procesit të rishikimit të brendshëm të këtij produkti, MPR-ja verifikon saktësinë e gjetjeve dhe mbledh informacione të mëtejshme përmes rishikimit të kolegëve, reagimeve të Njesisë për Mbështetje të PQH-së sipas nevojës, intervistave dhe vërtetimit me

palët e interesuara të vendit dhe mbikëqyrjes nga Paneli i Ekspertëve Ndërkombëtarë të MPR-së.

Siç u përshkrua më herët, MPR-ja mbështetet në **tre tregues kryesorë** për këtë rishikim:

I. Verifikueshmëria

- **Po, mjaftueshëm specifike për t'u rishikuar:** Siç është shkruar në planin e veprimit, objektivat e deklaruara dhe veprimet e propozuara janë mjaft të qarta dhe përfshijnë aktivitete të verifikueshme objektivisht për të vlerësuar zbatimin.
- **Jo, nuk është aq specifike sa të rishikohet:** Siç është shkruar në planin e veprimit, objektivat e deklaruara dhe veprimet e propozuar nuk kanë qartësi dhe nuk përfshijnë aktivitete të qarta të verifikueshme për të vlerësuar zbatimin.
- Zotimet që nuk janë të verifikueshme do të konsiderohen të parashikueshme dhe vlerësimi i mëtejshëm nuk do të bëhet.

II. Lentja e hapur e qeverisë

Ky tregues përcakton nëse zotimi lidhet me vlerat e qeverisë së hapur për transparencën, pjesëmarrjen qytetare ose llogaridhënien publike, siç përcaktohet në Deklaratën e Qeverisë së Hapur dhe Nenet e Qeverisjes së PQH-së duke iu përgjigjur pyetjeve udhëzuese më poshtë. Bazuar mbi leximin me kujdes të tekstit të zotimit, MPR-ja së pari përcakton nëse zotimi ka një lente të hapur qeveritare:

- **Po/Jo:** A përcakton zotimi që një fushë e politikave, institucion ose proces i vendimmarrjes të bëhet më transparent, pjesëmarrës ose i përgjegjshëm për publikun?

MPR-ja përdor vlerat e PQH-së siç përcaktohet në Nenet e Qeverisjes. Për më tepër, pyetjet e mëposhtme për secilën vlerë të PQH-së mund të përdoren si referencë për të identifikuar lentet specifike të qeverisë së hapur në analizën e zotimit:

- **Transparenca:** A do të zbulojë qeveria më shumë informacion, do të përmirësojë kornizat ligjore ose institucionale për të garantuar të drejtën e informacionit, do të përmirësojë cilësinë e informacionit të zbuluar për publikun ose do të përmirësojë transparencën e proceseve të vendimmarrjes qeveritare ose institucioneve?
- **Pjesëmarrja qytetare:** A do të krijojë apo do të përmirësojë qeveria mundësitë, proceset ose mekanizmat për publikun për të informuar ose ndikuar mbi vendimet? A do të krijojë, mundësojë ose përmirësojë qeveria mekanizmat pjesëmarrës për pakicat ose grupet e nënpërfaqësuar? A do të mundësojë qeveria një mjedis ligjor për të garantuar liritë e grumbullimeve, shoqatave dhe protestave paqësore?
- **Përgjegjësia publike:** A do të krijojë apo do të përmirësojë qeveria mundësitë për t'i mbajtur zyrtarët përgjegjës për veprimet e tyre? A do të mundësojë qeveria një kornizë ligjore, politike apo institucionale për të nxitur përgjegjësinë e zyrtarëve publikë?

III. Potenciali për rezultate

MPR-ja e përshtati këtë tregues - i njohur më parë si treguesi i "ndikimit të mundshëm" - për të marrë parasysh reagimet nga procesi i konsultimit të MPR Refresh me komunitetin PQH. Me fokusin e ri strategjik të orientuar drejt rezultateve të produkteve të MPR-së, MPR-ja e modifikoi këtë tregues për të paraqitur rezultatet e pritshme dhe të mundshme që do të verifikohen në

Raportin e Rezultateve të MPR-së pas zbatimit. Duke pasur parasysh qëllimin e këtij Rishikimi të Planit të Veprimit, vlerësimi i potencialit për rezultate është vetëm një tregues i hershëm i mundësisë që zotimi duhet të japë rezultate domethënëse, bazuar në artikullimin e tij në planin e veprimit, në kontrast me gjendjen në fushat përkatëse të politikave.

Shkalla e treguesit përcaktohet si:

- **I paqartë:** Zotimi ka për qëllim vazhdimin e praktikave të vazhdueshme në përputhje me legjislacionin ekzistues, kërkesat ose politikat pa treguar vlerën e shtuar ose qasjen e zgjeruar të qeverisë në kontrast me praktikën ekzistuese.
- **Modest:** Një nismë pozitive, por e pavarur ose ndryshime në procese, praktika ose politika. Zotimi nuk gjeneron ndryshime detyruese ose të institucionalizuara në të gjithë qeverinë ose institucionet që qeverisin një fushë të politikave. Shembujt janë mjetet (të tilla si faqet e internetit) ose lëshimi i të dhënave, trajnimi ose projekte pilot.
- **Thelbësor:** Një ndryshim i mundshëm tejet i madh për praktikën, politikat ose institucionet që drejtojnë një fushë politikash, sektor publik ose marrëdhëniet midis qytetarëve dhe shtetit. Zotimi gjeneron ndryshime detyruese dhe të institucionalizuara në të gjithë qeverinë.

Ky rishikim është përgatitur nga MPR-ja dhe është shqyrtuar nga Brendan Halloran, ekspert i jashtëm i MPR-së. Metodologjia e MPR-së, cilësia e Produktet të MPR-së dhe procesi i rishikimit mbikëqyren nga Paneli Ndërkombëtar i Ekspertëve të MPR-së. Për më shumë informacion, referojuni pjesës "Përmbledhja e MPR-së" në faqen e internetit të PQH-së.⁶³

⁶³ Përmbledhja e MPR-së: <https://www.opengovpartnership.org/MPR-guidance-overview/>

Shtojca 1. Të dhënat e secilit zotim⁶⁴

Zotimi numër 1.1: Ueb-portali i shërbimeve elektronike për Kosovën (e-Kosova)

- I verifikueshëm: Po
- A ka një lente të hapur qeveritare? Po
- Potenciali për rezultate: Modest

Zotimi numër 1.2: Integrimi i modulit të ri (e-Komunat) brenda e-Kosova me qëllim që të digjitalizohen të gjitha shërbimet komunale

- I verifikueshëm: Po
- A ka një lente të hapur qeveritare? Po
- Potenciali për rezultate: Modest

Zotimi numër 1.3: Sistemi online për raportimin dhe vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore

- I verifikueshëm: Po
- A ka një lente të hapur qeveritare? Po
- Potenciali për rezultate: Modest

Zotimi numër 2.1: Publikimi i të dhënave të qeverisë përmes portalit të të dhënave të hapura

- I verifikueshëm: Po
- A ka një lente të hapur qeveritare? Po
- Potenciali për rezultate: Modest
- Ky zotim është grupuar si të Dhëna të Hapura (Zotimet 2.1-2.4 të planit të veprimit)

Zotimi numër 2.2: Rritja e numrit të bazave të të dhënave të publikuara në portalin e të dhënave të hapura me 30%

- I verifikueshëm: Po
- A ka një lente të hapur qeveritare? Po
- Potenciali për rezultate: Modest
- Ky zotim është grupuar si të Dhëna të Hapura (Zotimet 2.1 dhe 2.2 të planit të veprimit)

Zotimi numër 2.3: Ofrimi i ndihmës (teknike) për zyrtarët publikë për publikimin e të dhënave

- I verifikueshëm: Po
- A ka një lente të hapur qeveritare? Po
- Potenciali për rezultate: Modest
- Ky zotim është grupuar si të Dhëna të Hapura (Zotimet 2.1-2.4 të planit të veprimit)

Zotimi numër 2.4: Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e të dhënave të hapura

- I verifikueshëm: Po
- A ka një lente të hapur qeveritare? Po
- Potenciali për rezultate: Modest
- Ky zotim është grupuar si të Dhëna të Hapura (Zotimet 2.1-2.4 të planit të veprimit)

Zotimi numër 3.1: Përmirësimi i platformave ekzistuese për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje

- I verifikueshëm: Po
- A ka një lente të hapur qeveritare? Po
- Potenciali për rezultate: Modest

Zotimi numër 3.2: Fushata për të parandaluar përhapjen e padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (PSKPP)

- I verifikueshëm: Po
- A ka një lente të hapur qeveritare? Po
- Potenciali për rezultate: Modest

Zotimi numër 3.3: Mekanizmat për ankesat e qytetarëve për shërbimet publike

- I verifikueshëm: Po
- A ka një lente të hapur qeveritare? Po
- Potenciali për rezultate: I paqartë

Zotimi numër 4.1: Sistemi i prokurimit publik plotësisht i hapur

- I verifikueshëm: Po
- A ka një lente të hapur qeveritare? Po
- Potenciali për rezultate: Modest

Zotimi numër 4.2: Rekrutimi transparent i zyrtarëve të nivelit të lartë

- I verifikueshëm: Po
- A ka një lente të hapur qeveritare? Po
- Potenciali për rezultate: Modest

Zotimi numër 4.3: Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe kontrollit financiar të partive politike të regjistruara në Republikën e Kosovës.

- I verifikueshëm: Po
- A ka një lente të hapur qeveritare? Po
- Potenciali për rezultate: Modest

⁶⁴ **Shënime editoriale:**

1. Për zotimet që janë të grupuara, vlerësimi i potencialit për rezultate kryhet në nivelin e grupeve dhe jo në zotimet individuale.
2. Titulli i shkurtër i zotimit mund të jetë redaktuar për shkurtësi. Për tekstin e plotë të zotimeve, ju lutemi shikoni planin e veprimit të Kosovës: <https://www.opengovpartnership.org/documents/kosovo-action-plan-2023-2025-december/>

Shtojca 2: Bashkë-krijimi i Planit të Veprimit

Vendet anëtare të PQH-së nxiten të synojnë ambicien e plotë të Standardeve të Pjesëmarrjes dhe të Bashkë-krijimit të PQH-së që hyri në fuqi më 1 janar 2022.⁶⁵ MPR-ja vlerëson të gjitha vendet që kanë paraqitur plane veprimi nga viti 2022 e në vazhdim sipas standardeve të përditësuara. Tabela 2 përshkruan masën në të cilën praktikatat e pjesëmarrjes dhe të bashkë-krijimit të vendeve përmbushin kërkesat minimale që zbatohen gjatë zhvillimit të planit të veprimit.

PQH-ja vendosi një periudhë kalimtare 24-mujore për të siguruar një tranzicion të drejtë dhe transparent në standardet e përditësuara. Planet e veprimit të bashkë-krijuara dhe dorëzuara deri më 31 dhjetor 2023 bien brenda periudhës së tranzicionit. MPR-ja do të vlerësojë përputhshmërinë e vendeve me standardet dhe kërkesat e tyre minimale.⁶⁶ Megjithatë, vendet do të konstatohet se po veprojnë në kundërshtim me procesin vetëm nëse nuk plotësojnë kërkesat minimale për planet e veprimit të bashkë-krijuara në vitin 2024 e në vazhdim.

Ju lutemi vini re se, sipas Manualit Kombëtar të PQH-së, vendet që zbatojnë plane veprimi katërvjeçare duhet të ndërmarrin një proces rifreskimi pas dy vjetësh. Vendet pritet të plotësojnë kërkesat minimale 3.1 dhe 4.1 gjatë procesit të rifreskimit.⁶⁷ Vlerësimi i MPR-së për procesin e rifreskimit do të përfshihet në Raportin e Rezultateve.

Tabela 2. Pajtueshmëria me kërkesat minimale

Kërkesat minimale	U plotësua gjatë bashkë-krijimit?	U plotësua gjatë zbatimit?
1.1 Hapësira për dialog: Forumi shumëpalësh i Kosovës, Komiteti Koordinues Kombëtar (KKK), u themelua në korrik 2021. KKK përbëhet nga 17 përfaqësues të shoqërisë civile dhe 12 përfaqësues të qeverisë. Rrjeti ombrellë i OSHC-ve në Kosovë, Civikos, lehtësoi përzgjedhjen e anëtarëve të shoqërisë civile dhe ftoi organizata që nuk ishin nën këtë ombrellë. ⁶⁸ KKK-ja ka mbajtur 11 takime, duke përfshirë shtatë diskutime publike në rajonet e Kosovës dhe katër punëtori tematike. ⁶⁹ Takimet rajonale u zhvilluan në komunat e Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Ferizajt, Gjilanit, Mitrovicës Jugore dhe Gjakovës. ⁷⁰	Po	<i>Do të vlerësohet në Raportin e Rezultateve</i>
2.1 Faqja e internetit të PQH-së: Ekziston një faqe interneti me qasje për publikun që përmban planin më të fundit të veprimit dhe informacionin mbi procesin e PQH-së. ⁷¹	Po	<i>Do të vlerësohet në Raportin e Rezultateve</i>
2.2 Depoja: Pjesa "Dokumentet" e faqes së internetit të PQH-së përmban planin e veprimit 2023-2025, një broshurë për planin e veprimit, letrën e synimit të Kosovës për t'iu bashkuar PQH-së si dhe pikët e Kosovës për kriteret e përshtatshmërisë së PQH-së. Pjesa "Lajmet" përmban lexime nga takimet dhe konsultimet e KKK-së për planin e veprimit. Që nga dhjetori 2023, kur u miratua plani i veprimit, përditësimi i fundit i kësaj pjese ishte më 26 korriku 2022. ⁷² Standardi 2 i kërkesës për bashkë-krijimin dhe pjesëmarrjen e PQH-së kërkon që anëtarët e PQH-së të mirëmbajnë dhe përditësojnë rregullisht (të paktën dy herë në vit) një depo dokumentesh të disponueshme publikisht, i cili ofron akses në dokumentet që lidhen me procesin e PQH-së, duke	Jo	<i>Do të vlerësohet në Raportin e Rezultateve</i>

<p>përfshirë informacionin dhe dëshmitë e bashkë-krijimit. procesit dhe të zbatimit të zotimeve. Sipas pikës së kontaktit, procesverbalet e mbledhjeve iu shpërndanë anëtarëve të KKK-së krahas materialeve të tjera.⁷³ Megjithatë, nuk është e mundur që MPR-ja të identifikojë shembuj të këtyre procesverbaleve. Sipas nënkryetarit të KKK-së, procesi i bashkë-krijimit përfshinte redaktim të përbashkët të një Google Drive të përbashkët, por ky Drajb nuk është më i disponueshëm.⁷⁴</p>		
<p>3.1 Njoftim i hershëm: Sipas pikës së kontaktit, ftesat, agjendat dhe materialet për çdo mbledhje të KKK-së iu dërguan pjesëmarrësve tre javë përpara. Pika e kontaktit u dërgoi pjesëmarrësve email dy herë, një javë para çdo takimi dhe përsëri një ditë përpara çdo takimi.⁷⁵ Megjithatë, nuk ka qenë e mundur të shihen këto emaile. Pjesa kryesore e procesit të bashkë-krijimit u zhvillua për dy muaj në mars-prill 2022. Njoftimi i vetëm i këtij procesi është një publikim në faqen e internetit të PQH-së pasi takimi i parë ishte mbajtur më 8 mars 2022.⁷⁶ Nuk ka asnjë provë që afati kohor i procesit të bashkë-krijimit me një pasqyrë të mundësive për pjesëmarrjen e palëve të interesuara është shpërndarë në faqen e internetit të PQH të paktën dy javë përpara fillimit të procesit të bashkë-krijimit, siç kërkohet nga Standardi 3 i PQH's, Bashkë-krijimi dhe Pjesëmarrja (edhe pse KKK-ja u formua përpara se këto standarde të hynin në fuqi).</p>	Jo	Nuk zbatohet
<p>3.2 Përhapja: Përveç 11 takimeve të punës së KKK-së, u realizua kontakt në shtatë diskutimet publike rajonale, duke mbledhur së bashku përfaqësues të institucioneve kryesore shtetërore, shoqërinë civile, median dhe qytetarë të interesuar për të diskutuar mbi temat kryesore të projekt-planit të veprimit: anti-korrupsion, qeverisja digjitale, hapja e të dhënave dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje. Përveç kësaj, u mbajtën katër punëtori për të mbledhur të dhëna nga ekspertët mbi fushat tematike të planit të veprimit.⁷⁷</p>	Po	Nuk zbatohet
<p>3.3 Mekanizmi i reagimit: Përveç seminareve dhe dialogëve rajonalë, projekt-planit i veprimit u ngarkua në portalin konsultativ të qeverisë për 60 ditë që qytetarët të jepnin komente. Plani i veprimit e ka identifikuar këtë platformë si me hapësirë për përmirësim, pjesërisht sepse nuk ka funksion për të dhënë komente (komentet duhet të jepen me email).⁷⁸</p>	Po	Nuk zbatohet
<p>4.1 Përgjigja e arsyetuar: Pika e kontaktit iu përgjigj të gjitha emaileve të marra rast pas rasti për të gjitha palët e interesuara, por këto emaile nuk janë të rikuperueshme dhe për këtë arsye nuk mund të evidentohen.⁷⁹</p>	Jo	Nuk zbatohet
<p>5.1 Zbatimi i hapur: MPR-ja do të vlerësojë nëse janë mbajtur takime me palët e interesuara të shoqërisë civile për të prezantuar rezultatet e zbatimit dhe për t'i mundësuar shoqërisë civile të japë komente në Raportin e Rezultateve.</p>	Nuk zbatohet	<i>Do të vlerësohet në Raportin e Rezultateve</i>

⁶⁵ 2021 Standardet dhe Pjesëmarrjes dhe Bashkë-Krijimit në PQH, <https://www.opengovpartnership.org/ogp-participation-co-creation-standards/>

⁶⁶ Udhëzimet e MPR-së për Vlerësimin e Kërkesave Minimale: <https://www.opengovpartnership.org/documents/MPR-guidelines-for-the-assessment-of-minimum-requirements/>

⁶⁷ Doracaku Kombëtar i PQH-së 2022, Pjesa 2.3: <https://www.opengovpartnership.org/documents/ogp-national-handbook-rules-and-guidance-for-participants-2022/>

⁶⁸ Fidan Kajala (PeK), intervistë dhe korrespondencë me MPR-në

⁶⁹ Plani Kombëtar i Veprimit për Kosovën 2023-2025, f. 7

⁷⁰ Nënkyetar i KKK-së, intervistë e kryer nga MPR-ja, qershor 2024; Partneriteti për Qeverisje të Hapur në Kosovë, <https://ogpkosova.org/>

⁷¹ Partneriteti për Qeverisje të hapur në Kosovë, <https://ogpkosova.org/>

⁷² Partneriteti për Qeverisje të Hapur në Kosovë, Konsultimet e hapura të draft Planit Kombëtar të Veprimit 2023-2025 për PQH Kosova, <https://ogpkosova.org/news5>

⁷³ Fidan Kajala (PeK), korrespondencë me MPR-në, qershor 2024.

⁷⁴ Fidan Kajala (PeK) dhe nënkryetar i QKK-së, intervistë e kryer nga MPR-ja, qershor 2024.

⁷⁵ Fidan Kajala (PeK), korrespondencë me MPR-në, qershor 2024.

⁷⁶ Partneriteti për Qeverisje të Hapur në Kosovë, Debat publik mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur në Komunën e Prishtinës, Mars 2022, <https://ogpkosova.org/news4>

⁷⁷ Fidan Kajala (PeK), korrespondencë me MPR-në, qershor 2024.

⁷⁸ Fidan Kajala (PeK), intervistë e kryer nga MPR-ja, qershor 2024.

⁷⁹ Fidan Kajala (PeK), intervistë dhe korrespondencë me MPR-në, qershor 2024.